



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/53
Datë: 29.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet dhe transkriptet nga mbledhjet: 40, 43 dhe 48 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet korresponduese elektronike: 46, 47, 49 dhe 51 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/53

Datë: 29.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Punës së Qeverisë për vitin 2021 dhe Plani Indikativ i Punës së Qeverisë për vitet 2022 dhe 2023, me shtojcat: Programi Legjislativ dhe Plani i Dokumenteve Strategjike.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin Legjislativ për vitin 2021 t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/53

Datë: 29.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Përdorimin e Njësive Matëse Ligjore.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/53

Datë: 29.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 3. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 18/48 të datës 07.12.2020, ashtu që afati i paraparë për paraqitjen e analizës/studimit nga Grupi Punues për Themelimin e Institutit për hulumtimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë të shtyhet deri më datën 15.04.2021.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Anëtarëve të grupit të ekspertëve
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/53

Datë: 29.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Drejtësisë për nënshkrimin e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Civile me Maqedoninë e Veriut.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Drejtësisë për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/53

Datë: 29.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-221; Ligjin 04/L-116, Ligjin 04/L-194; 05/L-063, dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 8 të Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, i plotësuar dhe ndryshuar Ligjin Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet reduktimi dhe ri-destinimi i alokimeve të lira nga fondi burimor AKP (24), nga lista e projekteve kapitale të pa shpenzuara, të të gjitha projekteve me fonde të lira nga AKP, bazuar në regjistrat kontabël aktual të SIMFK, deri në vlerën e 17,456,665.27 euro, dhe përdorimi i tyre për të rimbursuar shpenzimet e ndodhura nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, në pajtim me Nenin 8 të Ligjit Nr. 07/L-016 Për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid-19.
2. Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike (29300), Organizata Buxhetore Ministria e Financave, me kod 201, ndarja buxhetore 100,000,000 euro me fondet e AKP (24) i pa financuar me fonde shtese nga AKP, financohet nga mjetet e pashpenzuara te AKP-së nga projektet kapitale, të lira për t'u ri-destinuar sipas pikës 1. të këtij vendimi.
3. Mjetet nga pika 2. e këtij vendimi, transferohen dhe ri-alokohen te organizata buxhetore Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, me kod 213, Programi Ndërmarrësia, me kod 49400, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, sipas paragrafit 1. të nenit 24A, të Ligjit Nr. 07/L-014 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020.
4. Mjetet nga pika 3. e këtij vendimi përdoren për të rimbursuar pjesërisht dhe zëvendësuar shpenzimet nga burimet e financimit të subvencionimit për bizneset sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/33 (i plotësuar dhe ndryshuar), si një nga masat e programit për rimëkëmbje ekonomike, bazuar në Vendimin Nr. 10/33, lidhur me piken 1., i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 14/34 i datës 07.10.2020, si plotësim ndryshimin e Vendimit Nr. 01/35 i datës 12.10.2020.

5. Autorizohet Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit dhe Thesari i Kosovës, për zëvendësimin e pjesshëm të ndarjeve buxhetore si dhe bartjen e shpenzimeve të ndodhura sipas bllokut kodues financiar '10/213/49400/21200/00098/041', përkatësisht kuponëve të shpenzimit të lidhur me të, deri në vlerën e alokuar sipas këtij vendimi. Kështu, bëhet zvogëlimi i grantit qeveritar (10) dhe rritet burimi i financimit Të hyrat e AKP (24) me qëllim të ndarjeve buxhetore përkatëse dhe bartjes së shpenzimeve, ne pajtim me nenin 8, paragrafi. 1, i Ligjit Nr. 07/L-016 Për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid-19, për mbulimin e shpenzimeve nga zbatimi i masës sipas pikës 4 të këtij Vendimi dhe në përputhje me Vendimin e Qeverisë Nr. 01/23, datë 13.08.2020.
6. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Arsyetim


Fondet nga AKP me ligjin Nr. 07/L-001 Mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, janë ndarë për projektet kapitale në vlerë prej 85 milionë euro, prej të cilave, gjatë vitit nga AKP është pranuar shuma prej 70.4 milionë euro, e cila është alokuar te projektet e organizatave buxhetore sipas ligjit të buxhetit. Në fund të vitit fiskal dhe pas kalimit të afatit ligjor për shpenzim (datë 24 dhjetor), konstatohet se nga këto alokime kanë mbetur të pa shpenzuara, në shumë prej 17.45 milionë euro, si mjete të lira nga fondet e AKP-së, bazuar në regjistrat kontabël të datës 26.12.2020, deri kur këto fonde mund të përdreshin.

Sipas ligjit të rishikuar të buxhetit (Nr. 07/L-014), nga fondi AKP janë parashikuar 100 milionë euro mjete shtesë për të financuar programin e rimëkëmbjes ekonomike (që në total janë 185 milionë euro nga AKP të planifikuara). Megjithatë, për këtë qëllim fonde shtesë nga AKP nuk janë pranuar. Prandaj, meqë edhe mjetet e mbetura të pashpenzuara janë mjete të AKP-së, bazuar në dispozitat e ligjit Nr. 07/L-016, Neni 8, mjetet nga AKP mund të përdoren për të financuar rimëkëmbjen ekonomike, këto mjete janë të lira dhe nga burim i financimit AKP, do të alokohen për zëvendësuar burimet e financimit (grant qeveritar) të përdorur për të financuar pakon e rimëkëmbjes ekonomike në vlerë prej 60 milionë euro ndihme për sektorin privat, në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/33, lidhur me piken 1., i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin Nr. 14/34 i datës 07.10.2020, si plotësim ndryshimin e Vendimit Nr. 01/35 i datës 12.10.2020. Rimbursimi i linjave bëhet deri në vlerën e këtij vendimi, varësisht nga nevoja për të rimbushur shpenzimet, duke respektuar kufirin e bilancit bankar të shfrytëzueshëm.

Neni 24A i ligjit të buxhetit të rishikuar, ka paraparë Programin për Rimëkëmbje Ekonomike, në kuadër të Ministrisë së Financave, prej të cilit me vendime të Qeverisë mjetet transferohen të OB përgjegjëse për zbatim të masave të rimëkëmbjes, ndaj edhe është propozuar marrja e këtij vendimi, me qëllim që të mos barten obligime nga kufizimet ligjore për bilancin bankar të shfrytëzueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Pas këtij vendimi, në regjistrin kontabël të financave publike (SIMFK) mund të mos ketë mjete me fondin burimor AKP (24) të pashpenzuara dhe ruajtura për vitin fiskal 2020.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Sinjali



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/53
Datë: 29.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-221; Ligjin 04/L-116, Ligjin 04/L-194; 05/L-063, dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, Nenit 8 të Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, i plotësuar dhe ndryshuar Ligjin Nr. 07/L-014 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet mjetet financiare në shumë prej 1,047,710.96 € (një milion e dyzetëeshtatë mijë e shtatëqindëdhjetë, e nëntëdhjetëegjashhtë cent) për Agjencionin për Shërbimet e Navigimit Ajror, për mbulimin e deficitit të shkaktuar nga mjetet e pa mjaftueshme të mbledhura nga të hyrat e dedikuara (me fond 23) si burime të financimit të buxhetit, e të financuara përkohësisht nga granti qeveritar.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga teprica e mjeteve të pashpenzuara, përkatësisht pa alokuara të Organizata Buxhetore Ministria e Drejtësisë, me kod 215, programi 37900, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.
3. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij vendimi, transferohen në Agjencionin për Shërbimet e Navigimit Ajror, me kod 254, në nën-programin Agjensioni për Shërbim të Navigimit Ajror me kod 37600 në kategorinë e ekonomike, si në vijim:
 - 3.1. Paga dhe Shtesa në shumë prej 240,693.10 euro;
 - 3.2. Mallra e shërbime në shumë prej 112,385.86 euro, dhe
 - 3.3. Shpenzimet kapitale në vlerë prej 694,632.00 euro, për kodet e projekteve si në vijim: 18082 (në vlerë 17,829.00 euro), 18228 (në vlerë 31,612.00 euro), 15222 (në vlerë 173,781.00 euro) si dhe 15600 në vlerë (471,410.00 euro).
4. Autorizohet Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit dhe Thesari i Kosovës që të bëjnë zëvendësimin e ndarjeve buxhetore të burimit të financimit - zvogëlimin nga burimi i financimit të hyrat e dedikuara (23) dhe rritja e burimit të financimit nga granti qeveritar (10) për buxhetimin dhe alokimin e buxhetit si dhe bartjen e shpenzimit nga fondi i të hyrave të dedikuara (23) në fondin granti qeveritar (10), me qëllim të harmonizimit të linjave buxhetore të organizatës buxhetore Agjensioni për Shërbimet e Navigimit Ajror, dhe në bashkëpunim me të.
5. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi brenda datës 31.12.2020.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

ASHNA financohet sipas ligjit të buxhetit nga të hyrat e dedikuara. Megjithatë, sipas nenit 8, paragrafi 4, për të plotësuar kërkesat e përcaktuara në planin e rrjedhës së parasë së gatshme të dorëzuar në Thesar, atëherë Thesari do të lejojë alokimet sipas planit të rrjedhës së parasë të agjencisë, kurse fondet e tjera publike nga Fondi i Kosovës autorizohen nga Ministri në një shumë të mjaftueshme për të plotësuar deficitin. Përveç pageses së pagave, alokim tjetër nga Thesari nuk është dhënë në TM3 dhe TM4, pasur parasysh mungesen e të hyrave dhe mos zëvendësimin e tyre gjatë vitit fiskal. Meqë për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19 në të hyrat e ASHNA, përkatësisht mos realizimit të planit, deficitin midis shpenzimit të ndodhur dhe të hyrave të pranuar, mbetet përfundimtar për vitin 2020, duhet të jepet ndarje nga granti qeveritar dhe të zëvendësohet burimi i financimit nga të hyrat e dedikuara. Siç dihet shërbimet e ASHNA janë të një natyre të ndjeshme të sigurisë.

Ndarjet nga ky vendim nuk prodhojnë shpenzime shtese dhe as dalje të parasë, përveç së mundësojnë zëvendësimin e burimeve të financimit dhe bartjen e shpenzimit në burimin përkatës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Sinjali